



UNIVERSITETI I PRISHTINËS  
"HASAN PRISHTINA"  
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.: 2/114

Datë: 13/10/2020

Senati i Universitetit të Prishtinës në mbledhjen e mbajtur më 07.10.2020, bazuar në Vendimin nr.2/112, dt.13.10.2020 për plotësim-ndryshim të paragrafit 2 të nenit 5 të Rregullores për procedurat vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në Universitetin e Prishtinës, mori këtë:

**VENDIM**

*Për angazhim të bashkëpunëtorëve të jashtëm për vitin akademik 2020/21*

- I. Lejohet angazhimi i bashkëpunëtorëve të jashtëm të cilët kanë qenë të kontraktuar sipas konkursit publik të vitit paraprak (2019/20), përveç nëse për vitin akademik 2019/20 ka vendim të shkallës së dytë të Trupës Ekzekutive të Inspektoratit të Punës (TEIP) me të cilin fakulteti përkatës obligohet që të angazhoj një person tjetër.
- II. Angazhimi i bashkëpunëtorëve të jashtëm si në pikën 1 të këtij vendimi do të bëhet sipas nevojës dhe fondit të orëve në dispozicion, por jo mbi fondin e orëve të përcaktuar sipas Rregullores për të ardhurat personale.
- III. Për ligjërata apo ushtrime nga lëndët e njëjta për të cilat kanë qenë të angazhuar dy apo më shumë bashkëpunëtorë të jashtëm, ndërsa në vitin akademik 2020/21 fondi i orëve është zvogëluar apo rritur, shpërndarja e orëve do të bëhet proporcionalisht për të gjithë të angazhuarit nga viti paraprak.
- IV. Për ligjërata apo ushtrime të cilat nuk mund të mbulohen nga personel të brendshëm bashkëpunëtorët e jashtëm, dekanati obligohet që orët ti mbuloj me studentë të doktoratës. Studentët e doktoratës nuk
- V. do të kompensohen për ushtrime të mbajtura.
- VI. Angazhimi i bashkëpunëtorëve të jashtëm mund të bëhet vetëm pasi të plotësohet norma dhe mbinorma e personelit sipas prioriteteve në vijim:
  1. Personeli akademik në marrëdhënie të rregullt pune.
  2. Personeli i cili në momentin e plotësimit të moshës mandatore të pensionit ka qenë në marrëdhënie të rregullt pune në Universitetin e Prishtinës dhe nëse fakulteti ka nevojë për angazhimin e tyre. Angazhimi i kësaj kategorie të bashkëpunëtorëve bëhet deri në moshën e lejuar me akte të veçanta. Këshilli i fakultetit nxjerr vendimin për angazhimin e kësaj kategorie për vitin akademik përkatës.
  3. Profesorët vizitorë nga vendet tjera të punësuar në Universitetet respektive (për një numër të caktuar të ligjëratave deri në një semestër), me vendim të Senatit.

- VI. Njësitë akademike mbajnë përgjegjësi për zbatimin e këtij vendimi dhe llogaritjes së saktë të fondit të orëve për angazhim.
- VII. Personeli që ka qenë i angazhuar në vitin akademik 2019/20, mirëpo nuk ka pasur fond të plotë të orëve deri në numrin e lejuar sipas Rregullores përkatëse, mbi bazën e nevojave të fakultetit, për vitin akademik 2020/21 mund t'i plotësohet norma nga lëndët e përafërta të fushës së studimit.


#### Arsyetim

Duke pasur parasysh rrethanat e Pandemisë Covid-19 dhe pamundësisë për shpalljen e konkursit për angazhim të bashkëpunëtorëve të jashtëm në fazën e fillimit të vitit akademik 2020/21, për shkak të kohëzgjatjes së procedurave prej hapjes e deri në përzgjedhjen e bashkëpunëtorëve të jashtëm, sekretari i përgjithshëm me rekomandim të rektorit ka kërkuar nga Kryeinspektori i punës që të jap pëlqim për ndryshim të nenit 5, paragr. 2 të Rregullores për procedurat vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në Universitetin e Prishtinës dhe për lejimin e angazhimit të bashkëpunëtorëve të jashtëm për vitin akademik 2020/21, sipas konkursit të vitit akademik 2019/20.

Meqenëse legjislacioni i Kosovës nuk parasheh zgjidhje alternative në situata të pandemisë dhe raste të ngjashme që shkaktohen si rezultat i fuqisë madhore, Kryeinspektori i punës ka konstatuar se çështja e angazhimeve të bashkëpunëtorëve të jashtëm mbetet në dispozicion të UP-së në mënyrë që brenda autonomisë të vlerësohen specifikat e angazhimeve të bashkëpunëtorëve të jashtëm, prandaj bazuar në këtë konstatim dhe rrethanat e pandemisë COVID-19, Senati i UP-së pasi bëri plotësim ndryshimin e nenit 5, paragr. 2 të Rregullores për procedurat vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në Universitetin e Prishtinës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi t'u dërgohet:

1. Arkivit të UP-së,
2. Dekanëve dhe sekretarëve të Fakulteteve,
3. Menaxhmentit dhe Sekretarit të UP-së,
4. Zyrës për çështje akademike,
5. Shërbimit të financave të fakulteteve, dhe
6. Shërbimit të financave të UP-së.



Kryesues i Senatit

Prof. Dr. Naser Sahiti, rektor